

05.07.2024

Ora 10:38

RENDI I DITËS

- 1. Projektvendim: “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.**

PJESËMARRJA :

- KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve : Z. Ilirjan Celibashi

2. Stafi KQZ: Pavlina Docaj, Madalena Koja, Jona Josifi

3. Perfqësues të partive politike : Eridjan Salianji, Ivi Kaso

4. Fredi Beleri , Av.Klodiana Gjyzari, Vangjel Dule

Z.I.Celibashi: Mirëmëngjes. Atëherë, në seancën e djeshme vendosëm që të ftojme subjektin e interesuar, kryetarin e zgjedhur të Bashkisë Himarë zotin Dhionisios Alfred Petro Beleri për të qenë prezent në shqyrtimin administrativ që ka të bëjë me

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

vlefshmërinë e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë. Mesa shoh është prezent. Atëherë, fjala për avokaten, zoti Beleri e me rradhë.

Znj.K.Gjyzari(avokate): Faleminderit! Atëherë në seancën e kaluar ne dëgjuaam relatimin e KQZ-së në lidhje me projektvendimin i cili është përgatitur për t'u diskutuar në mbledhjen e sotme. Paraprakisht unë doja ta filloja me faktin që procedura e ndjekur nga ana e KQZ-së është konfuze. Rezulton që nuk ka qartësi në lidhje me dispozitat procedurale që kanë vënë KQZ-në, nëse është vënë në lëvizje kryesisht apo është vendosur në lëvizje nga një shtetas i quajtur Eugen Likaj. Nga përmbatja e projektvendimit rezulton që të jetë vendosur në lëvizje nga shtetasi Eugen Likaj. Në rast se do t'i qëndronim strikt zbatimit të ligjit 138 të vitit 2015 në bazë të cilit është vendosur që të merret në shqyrtim vlefshmëria e mandatit të kandidatit të Kryetarit të zgjedhur të Bashkisë Himarë. Sipas këtij ligji verifikimin e vërtetësisë së formularit të dekriminalizimit ose të vetdeklarimit mund të kryhet sipas nenit 7 të ligjit 138 të vitit 2015 me iniciativë vetëm të disa subjekteve të përcaktuara ndër të cilat nuk është një individ i vetëm, një votues i vetëm, në qoftë se është votues në Bashkinë Himarë se nuk kemi të dhëna nga projektvendimi rezulton Tiranë nuk ka asnjë të dhënë për gjenalitet e tij, ku banon, me çfarë cilësie i drejtohet KQZ-së. Nuk ka kopje të kartës së identitetit të dhëna këto që duhet të ishin marrë dhe verifikuar që në momentin e paraqitjes së kërkesës. Në kushtet kur një individ i vetëm në mungesë të cilësive si Kryetar i Kuvendit, Kryeministër, Prokuror i Përgjithshëm apo një cilësi tjetër që parashikohet sipas nenit 7, paragrafi 1, pika A e Ligjit nr.138, ky shtetas i vetëm nuk mund të vendosë në lëvizje KQZ-në. Duhet të zgjedhë në qoftë se ky është votuesi i Bashkisë Himarë duhet të ketë marrë firmat e 4199 të zgjedhësve të tjerë që t'i drejtohet KQZ-zë për verifikimin e

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

të dhënave të deklaruara në formularin e vetdeklarimit. Jam e detyruar që të flas në të gjitha dispozitat e mundshme procedural, për sa i përket Kodit Procedurave Administrative dhe ligjit dhe Kodit Zgjedhor sepse projektvendimi nuk ka dispozita të përcaktuara në mënyrë që të na jepte mundësinë që të kuptonim mbi bazën e cilës dispozitë konkrete KQZ-ja është vendosur në lëvizje. Po t'i referohemi dispozitave e Kodit Zgjedhor KQZ-ja vendoset në lëvizje qoftë edhe nga një shtetas i vetëm vetëm në perjudhë zgjedhore, nuk jemi në periudhë zgjedhore kështu që nuk mund të vendoset në lëvizje me kërkesë të një shtetasi të vetëm. Së dyti në rast se do të vendosim lëvizjen me kërkesë të një shtetasi të vetëm, së pari KQZ-ja do të verifikonte kërkesat formale të kësaj kërkesë që ka vendosur në lëvizje KQZ-në të cilat nuk janë verifikuar. Kjo kërkesë nuk i përmban kushtet formale për të vendosur në lëvizje KQZ-në kjo sa për i përket Kodit Zgjedhor. Për sa i përket Ligjit të Dekriminilazimit siç e citova përsëri një shtetas i vetëm qoftë edhe votuesi i Bashkisë Himarë nuk mund ta vendosë në lëvizje KQZ-në. KQZ-ja mund të vendoset në lëvizje kryesisht nga indicia e një shtetasi të vetëm vetëm në bazë të Kodit Zgjedhor dhe vetëm gjatë periudhës zgjedhore, kjo për sa i përket procedurës. Për sa i përket anës materiale të projektvendimit, sipas ligjit 138 të vitit 2015 parashikohet ndalimi i nenit 2 për të kandiduar apo për të zgjedhur, në rastin konkret siç dhe ju relatuat prezencën e palëve, shtetasi Dhionisios Alfred Beleri e ka kaluar këtë fazë, tashmë është kryetari i zgjedhur i Bashkisë Himarë. Sipas nenit 10 që është cituar në projektvendim ky neni 10 vjen pas nenit 5, 6, 7, 8, 9. Në rast se do të ndiqni një interpretim sistematik të dispozitave të ligjit 138 të vitit 2015 atëherë që duhet të ishte bërë në marrjen e këtij projektvendimi dhe në marrjen e iniciativës vendimmarrjes dhe nga ana e Organit Administrativ do të shikonim që ky ligji 138 ka parashikuar në nenin 1 qëllimin e tij, në nenin 2 ndalesat dhe në nenin 3 ndalesat dhe në nenin 4 periudhën e ndalimit. Në nenin 5 fillon të shpjegojë procedurën dhe

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

thotë personat që janë të ndaluar sipas nenit 2 dhe 3 duhet të nënshkruajnë një formular vetdeklarimi në të cilin shkruajnë nëse kanë ndalesa apo jo. Ky nen parashikon dhe ku do të dorëzohet ky formular. Në nenin 6 parashikohet organi kompetent për miratimin e procedurave që në rastin konkret është Parlamenti. Në nenin 7 parashikohet e drejta e nisjes për verifikimin e të dhënave dhe po të vijojmë më poshtë në të gjithë përmbajtjen e ligjit bëhet fjalë që vlefshmëria sipas nenit 10, germa ç që ka marrë përsipër të kryhej KQZ-ja si Organ Administrativ shqyrtohet vetëm mbi bazën e verifikimit të të dhënave të vetdeklaruara në formularin e dekriminalizimit të dorëzuar nga subjekti Dhionisios Alfred Beleri në momentin e kandidimit. Kjo procedurë është përfunduar nga KQZ-ja, është kryer verifikimi, madje KQZ-ja i është drejtuar dhe Prokurorit të Përgjithshëm edhe në vijim për verifikim të thelluar të të dhënave të formularit të vetdeklarimit të subjektit Dhionisios Alfred Beleri. Do të ishim përpara vendimarrjes së KQZ-së në rast se nga ana e Prokurisë së Përgjithshme do të kishin rezultuar të dhënat të ndryshme nga ana të ndryshme të deklaruar në mënyrë të ndryshme nga ana e subjektit në formularin e vetdeklarimit sipas ligjit 138 të vitit 2015 që në rastin konkret nuk ekziston. Në përfundim të asaj që relatova, konstatoj që së pari KQZ-ja nuk ka kompetencën për shqyrtimin për të marrë këtë iniciativë për arsye se nuk ia ka parashikuar as Kodi Zgjedhor as neni 138 të drejtën që kryesisht të vendosë të shqyrtojë vlefshmërinë e zgjedhjeve në fazën që janë aktualisht, kur shtetasi Dhionisios Alfred Beleri e ka marrë mandatin nga KQZ-ja duke qenë se nuk ka asnjë dispozitë të ligjit 138 të vitit 2015 dhe asnjë dispozitë të Kodit Zgjedhor që i jep të drejtë që në këtë fazë që është procesi i shtetasit Dhionisios Alfred Beleri nga ana e KQZ-së të merren iniciativa të tilla. Përveç kësaj sipas Kodit Zgjedhor dhe ligjit 138 të vitit 2015, KQZ-ja mund të kryejë një verifikim të tillë vetëm bazuar mbi të dhënat e formularit të dekriminalizimit. Asnjë e dhënë jashtë formularit të dekriminalizimit nuk mund të

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

merret në shqyrtim nga KQZ-ja për të shqyrtuar vlefshmërinë e mandatit të shtetasit Dhionisios Alfred Beleri. Në këto kushte e gjithë procedura është e pavlefshme pasi sipas Kodit të Procedurave Administrative, Organi Administrativ ka tejkeluar kompetencat që i parashikon ligji dhe ne kërkojmë pushimin e procedurës për shkak së është një procedurë në tejkalim të kompetencave.

Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit e nderuar zonja avokate. Domethënë me pak fjalë ju jeni duke thënë që KQZ-ja nuk është kompetente për ta shqyrtuar për faktin sepse i mungon shkaku juridik për t'u vënë në lëvizje për këtë procedurë administrative dhe e dyta nuk jemi në kushte që përcakton ligji sipas të cilit KQZ-ja ka të drejtën në një rast të tillë që të vendosi në lidhje me mandatin.

Znj.K.Gjyzari(avokate): Po, pak a shumë kështu dhe për sa i përket iniciativës për të kryer verifikimin dhe për sa i përket anës materiale kompetencave që ligji I parashikon KQZ-së. Edhe sikur të kishte iniciativë kryesisht, përsëri KQZ-ja nuk ka kompetencë në fazën që është aktualisht. Për arsye sipër citova që vetëm mbi formularin e dekriminalizimit KQZ-ja mund të marrë vendimarrjen.

Z.I.Celibashi: Për ta qartësuar, jeni duke thënë se kompetenca e KQZ-së shtrihet vetëm për rastin e kandidimit dhe mbi bazë shqyrtimin e formularit të dekriminalizimit.

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

Znj.K.Gjyzari(avokate): Po.


Z.I.Celibashi: Tej kësaj pastaj KQZ-ja nuk ka asnjë lloj kompetence, domethënë në raste kur verifikohet që një person i emëruar në një funksion publik në listën e atyre që e ka përshkruar ligji për dekriminalizimin nuk ka asnjë lloj kompetence lëndore shqyrtuese Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Mund të ndalohet dikush të marrë një zyrë të kandidojë për të marrë një funksion publik kur është një nga veprat penale ku pretendohet ose vërtetohet që e ka kryer një nga veprat penale për të cilat ligji e ndalon, por në momentin kur verifikohet që kjo vepër penale kryhet gjatë ushtrimit të detyrës nuk është kompetencë KQZ-ja po thoni.

Znj.K.Gjyzari(avokate): Jo.

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Nuk është se ka ndonjë rradhë në shqyrtimin administrativ, kështu që gjithësecili prej jush mund ta marrë fjalën. Po zoti Salianji!

Z.E.Salianji (Përfaqësues i PS-së): Për sa i përket këtij fakti përveç kazusit që është bërë publik, përveç personit i cili është pjesë i këtij shqyrtimi administrativ i gjithë procesi të jetë e bën këtë seancë të rëndësishme edhe nga ana formale. Kurse për sa i përket anës thelbësore teknike ky është një proces automatik në momentin që ka dalë vendimi Gjykatës së Apelit dhe është rasti më tipik ku të gjithë palët nuk mund të diskutonin për thelbin dhe për procedurën në këtë rast. Vetë KQZ-ja në daljen e vendimit të formës së prerë me vendimin e Apelit që ka marrë dijeni ditën

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

e premtë kur është bërë gjykimi para një jave mund ta kishin konstatuar që në atë moment se ligji i dekriminalizimit nuk interpretohet një nen në një pjesë e një nen në pjesë tjetër, por thelbi i ligjit të dekriminalizimit është personat e dënuar me vendim Gjykatës në rastin konkret Apelit të formës së prerë nuk mund të ushtrojë funksione publike dhe në interpretim të këtij ligji në kompleksin e tij KQZ-ja ka diskrecionin dhe gjithë të drejtën për ta hequr, për ta ndërprerë mandatin konkret që jemi për Kryetarin e Bashkisë Himarë dhe automatikisht të njoftojë organet për shpalljen e zgjedhjeve. Siç e thashë në fillim ky është një proces automatik nuk mundet të diskutojmë në momentin që ka vendim të Gjykatës së Apelit. Këtu jemi thjesht për konstatimin e faktit a ka vendim Gjykata e Apelit? Po apo jo, kjo është pyetja që do të bëjmë në këtë seancë, pastaj kush bëri kërkesën si u bë kërkesa e bëri KQZ-ja po apo jo unë besoj që në akt del fare qartë, por ne mund ta marrim edhe si indicie kërkesën që ka sjellë një qytetar këtu por rasti konkret KQZ-ja është rasti tipik në të cilët duhet të veprojë dhe koha që duhet të veprojë thashë dhe dje është një kohë shumë e shpejtë sepse vet ligji KQZ-së i ka dhënë të drejtën që të konstatojë dhe të shpallë të pavlefshëm mandatin dhe të njoftojë Presidentin i cili Presidenti për këtë rast ka vetëm 48 orë kohë të mendohet, maksimumi. Këtu po diskutojmë që i thamë të gjitha por nuk thamë a jemi subjekt i ligjit të dekriminalizimit kjo është e vetmja pyetje që unë kisha për palën. Jemi ose nuk jemi subjekt i këtij ligji? Në qoftë se jemi subjekt të ligjit të dekriminalizimit, atëherë jemi në KQZ, besoj se jemi dhe atëherë nuk ngelet gjë tjetër vetëm ju i nderuar kryetar të shpallni vendimin dhe të përfundoni procedurën. Unë këtë pyetje kam për palën jeni subjekt i ligjit për dekriminalizimit po apo ajo?

Z.I.Celibashi: Po, zoti Ivi Kaso!

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

Z.I.Kaso (Përfaqësues i PD-së): Meqë po fillojmë po flasim kështu si subjekte dhe pa u lënë rradhën të interesuarve besoj se do të jemi më shkurt unë dhe Eridiani ndoshta dhe do jenë më gjatë.

Z.I.Celibashi: Zgjidheni rradhën sepse nuk është se ka një radhë të përcaktuar në këtë lloj shqyrtimi administrativ.

Z.I.Kaso (Përfaqësues i PD-së): : Shumë shkurt zoti kryetar, lidhur dhe me komentet që u ngritën nga përfaqësues të Partisë Socialiste tani ka një konfuzion unë se di është apo nuk është i qëllimshëm apo i pa qëllimshëm midis dispozitave të ligjit 138 të vitit 2015 ligji i famshëm i dekriminalizimit dhe ligji 139 po i vitit 2015 që është ligji për Organet e Vetqeverisjes Vendore. Ndoshta për PS-në është e njëjta gjë, ta shkarkojmë ligjin 138 me këtë ligj të dekriminalizimit apo ligjin 139 pak diferencë bën për PS-në. Por besoj për institucionet në funksion të një procesi të rregullt ligjor, duhet të bëjë diferencë të madhe. Më bëri pyetjen kolegu i nderuar është subjekt i ligjit të dekriminalizimit apo jo? Është subjekt i ligjit të dekriminalizimit e sanksionon edhe projektvendimi që është paraqitur sot për miratim edhe relacioni përkatës dhe në qoftë se do të ngushtohet vetëm këtu hetimi administrativ i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të pyeste Komisioneri ose administrata që me të drejtë ka pyetur, ka pasur detyrim për të deklaruar ky subjekt i zgjedhur Kryetari i Bashkisë Himarë? Ka pasur. Ka fshehur gjë në formularin e dekriminalizimit? Jo nuk ka fshehur mesa më rezulton edhe nga projektvendimi.

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

Atëherë në çfarë rasti aplikohet neni 10 I ligjit 138, pika ç? Në leximin tonë siç e shpjegoi me elokuencë dhe avokatja dhe në këndvështrimin e legjislatorit në ato raste kur në këtë moment kohor siç është edhe kryetari i zgjedhur i Bashkisë Himarë ka një mandat të dhënë nga KQZ-ja, ka një mandat të vleftësuar nga gjykata. Ka një mandat të cilin nuk ka mundur dot ta ushtrojë për kokfortësi të organeve tjera që nuk lidhen me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve qartësisht me maxhorancën me Kryeministrin e të tjera. Pra në këtë moment kohor, kjo është ngjashmëria e vetme momenti kohor në qoftë se del një fakt që nuk është paraqitur në formularin e dekriminalizimit, pra që të ketë ndodhur para marrjes së mandatit para momentit të kandidimit, atëherë ndërhyjnë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thotë ligji 138. Në rast të kundërt siç ishte hipoteza që ngriti Komisioneri, pra në qoftë se një person i zgjedhur i cili akoma nuk ka filluar të ushtrojë mandatin dënohet me vendim të formës së prerë siç është dhe ky rasti që relatohet dhe administrata çfarë ndodh atëherë aplikohet dhe ligji tjetër që vërtet është afër në kohë dhe në numër por është i gjithë i ndryshëm në filozofi siç është ligji për Organet e Vetqeverisjes Vendore i cili neni 62 parashikon rastin ku mbaron para kohe mandati që ka marrë kryetari i zgjedhur i Bashkisë Himarë pavarësisht se nuk ka mundur të ushtrojë dhe është rasti kur Këshilli i Ministrave pasi merr diejini për vendimin e formës së prerë vendosë ta shkarkojë të zgjedhurin. Çfarë ndodh në këtë rast? Tani duhet të bëj qartësi këtu edhe maxhoranca dhe Partia Socialiste, të cilën e përfaqëson kolegu im i nderuar, lidhur se si do ta trajtojë këtë çështje. Nuk është kjo një patate e nxehtë të cilën duam t'ia kalojmë KQZ-në e të mos merren. Në këtë rast maxhoranca, Partia Socialiste, duhet të vejë fytyrën në qoftë se do pas vendimit të formës së prerë ta shkarkojë ose t'i heqë mandatin Fred Belerit çfarë do të thotë kjo që Këshilli i Ministrave Edi Rama duhet të marrë përgjegjësinë ta shkarkojë sepse thotë se kemi të bjmë me një person i cili është dënuar me vendim të formës së prerë. Tani këtë gjë maxhoranca nuk do

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

ta bëjë sepse nuk do që ta fusë në ato afate kohore dhe ankimore që parashikon ligji 139 neni 62, pra që pasi ta shkarkojnë vendimi të bëhet përfundimtar kur të shprehet Gjykata Kushtetuese e të tjera pra kanë ngut që të bëjnë zgjedhjet në Bashkinë Himarë apo maxhoranca ka pasur ndonjë vullnet edhe dëshirë të fshehur që mandatin ose ndërprerjen e mandatit të Fredit Belerit ditën e djeshme t'i bënte dhuratë për 60-vjetor Kryeministrit Edi Rama, unë këtë nuk e di nuk e ndaj dot se nuk e di dëshirat e fshehura të Partisë Socialiste dhe të përfaqësuesit të FRESH-it që ka vënë në lëvizje këtë gjë mbase e ka pasur vërtet për t'ia bërë dhuratë Edi Ramës. Por në çdo rast unë vlerësoj që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të ndjekë rrugën ligjore dhe të konstatojë në këtë rast dhe në këtë hipotezë abstrakte që parashikon ligji dhe sot e kemi konkrete përpara jush, aplikohet neni 62 I ligjit 139 dhe jo neni 10 i ligjit 138 i vitit 2015. Kaq kisha shkurtimisht. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Do të donit të shtonit diçka, po zonja avokate!

Znj.K.Gjyzari(avokate): Doja vetëm për të sqaruar më shumë publikun se besoj ne që kemi njohuri juridike jemi të qartë, shteti bazohet mbi ligjin nuk bazohet me një paragraf të shkurtër që interpretojmë në mënyrë të ngushtë për të zgjedhur një situatë të caktuar e cila nuk është krijuar nga KQZ-ja nuk është krijuar as nga ne as nga KQZ-ja kjo situatë është krijuar nga subjekte të tjera të marrin përsipër përgjegjësitë le ta zgjidhin. KQZ-ja është organ administrativ i cili vepron në bazë të Kodit të Procedurave Administrative, në bazë të Kodit Zgjedhor por dhe në bazë të ligjit themeltar që është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila ka disa parime që thonë një nga parimet e shtetit është shteti i së drejtës dhe pluralizmi dhe


*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

e drejta për të zgjedhur mund të kufizohet në momentin kur ti aplikon për t'u zgjedhur, kur ti kandidonh për t'u zgjedhur atëherë të kufizohet e drejta për t'u zgjedhur kjo fazë ka kaluar. Në rast se ne duam të ndryshojmë Kushtetutën të vazhdojnë ta kundërshtojnë Kushtetutën i kanë mundësitë. Ligji 138 I vitit 20115 është një ligj me tre të pestat dhe në bazë të tij është ndryshuar dhe Kushtetuta dhe është përcaktuar kufizimi i të drejtës për t'u zgjedhur jo i të drejtës që ti të bësh betimin siç është interpretuar deri tani. Megjithatë siç edhe para thashë është vërtet me vendim të formës së prerë shtetasi Dhionisios Alfred Beleri është i dënuar por kjo nuk e pengon dhe nuk i jep të drejtë KQZ-së që të shqyrtojë dhe të rishikojë një vendim që ka marrë në vitin 2023 që i kanë dhënë mandatin sepse jeni duke e rishikuar një vendim të KQZ-së që është një akt administrativ me të cilën ka bërë të vlefshme zgjedhjet dhe i ka dhënë mandatin shtetasit Dhionisios Alfred Beleri. Ky rishikim i vendimit të KQZ-së bëhet vetëm për rrethana të cilat kish ndodhur para se KQZ-ja të merrte vendimin por u zbulua më pas ndërmjet verifikimit të formularit të dekriminalizimit gjë që nuk është ky rasti, në rast se pozita në pjesën tjetër të Republikës së Shqipërisë opozita në Bashkinë Himarë kërkon që të zgjidhë situatat që ka krijuar vetë me mekanizmat të ndryshme të cilat nuk janë parashikuar në ligj atëherë mendoj që nuk është vendi as KQZ-ja as ne që t'i japim orientimet. Unë kërkoj të zbatohet ligji nga KQZ-ja, zgjidhjet e tjera për situata që nuk janë krijuar nga KQZ-ja dhe nuk janë krijuar nga shtetasi Dhionisios Alfred Beleri nuk na përkasin ne të japim përgjigje meqënëse më bëri pyetjen. Nuk është detyra ime të japë përgjigje detyra është e atij që e bëri pyetjen. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Është në të gjithë të drejtën e gjithësecilit prej jush për të folur kur mendon dhe si mendon kështu që pa diskutim në këtë çështje. Po zoti Salianji!

Z.E.Salianji (Përfaqësues i PS-së):: Nga përgjigja e pyetjes ramë dakord që po jemi subjekt i ligjit të dekriminalizimit pra do të thotë që duhet të ndërpritet mandate, thjesht debate juridik mesa kuptova ka të bëjë me është KQZ-ja kopetente po se jo? Ligji e ka shumë të qartë për dekriminalizimin është organi i caktuar nga ligji i cili ndërpret mandatet për personat të cilët kanë qenë të dënuar ose dënohen gjatë ushtrimit të mandatit. Për sa i përket ajo që tha zoti Kaso që duhet qeveria ta shkarkonte nuk janë ezauruar e gjithë procedura ligjore për ushtrimin e mandatit, në qoftë se zoti Beleri do të kishte bërë betimin, do të ishte konfirmuar betimi dhe do të kishte filluar ushtrimin e detyrës atëherë mundet që Kryeministri ta shkarkonte. Por këtu nuk po diskutojmë shkarkimin është akt juridik se dhe nuk mund të ndodhë shkarkimi. Ne jemi në një rast që nuk ndodh shkarkimi, prandaj marrim sot rastin e i themi Kryetarit të KQZ-së shiko se po nuk u shkarkua ti nuk e ndërpret dot mandatin, jo nuk është ashtu nuk e shkarkon organi. Sot kemi diskutim një kryetar bashkie dhe shkarkimin mund ta bëjë qeveria por nesër mund të kemi dhe zyrtar publik i cili dënohet gjatë ushtrimit të detyrës dhe nuk e shkarkon titullari çfarë do të ndodhë, do të thotë që ai do të vazhdojë detyrën dhe nuk e ankon njeri pra dihet fakti public e pamë të gjithë në televizor nuk e shkarkon eprori, tani thuhet që KQZ-ja i paska duart e lidhura për personat të cilët dënohen me vendim të formës së prerë nuk vepron atëherë do të thotë që aio vazhdon detyrën jo nuk është folëm për kushtetutën folëm për ligjin është shumë e qartë për personat të cilët mundet të kenë qenë të dënuar kemi hetuar këtu për gjobë 4 mijë dhrahmi në Greqi, kemi bërë seanca

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

është dënuar nuk është dënuar dhe është zhvilluar dhe seanca gjyqësore. Kurse këtu rasti është shumë i thjeshtë kemi një vendim apeli nuk e diskutojmë dot rastin thjesht KQZ-ja do të bëjë vetëm konstatimin që e thashë në fillim në qoftë se do të ishte bërë betimi do të ishte shtuar detyra dhe mundet të shkarkohej por dhe shkarkimi.... KQZ-ja është shumë e ftohtë nuk e shkarkoi çfarë do të ndodhë? Prandaj dhe unë jam i mendimit që KQZ-ja dhe vetë kryesisht pas njoftimit publik të vendimit të apelit mundet ta kishte konstatuar këtë fakt dhe ta kishte marrë vendimin dhe më shumë shpejt se sot që flasim. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Po zoti Dule! Si kryetar i njëjës prej partive anëtare të Koalicionit Zgjedhor që ka propozuar zotin Beleri për kandidat për Kryetar të Bashkisë Himarë.

Z.V.Dule(Kryetar i Partisë PBDNJ-së): I nderuar zoti Komisionier. Në respekt të prezantimeve të juristëve, unë do dëshiroja që të theksoja që në fillim se sot jemi përpara një tentative për të përmbyllur një proces politik, i cili ka nisur me 6 Maj 2023. Synimi i këtij procesi ishte: uzurpimi i Bashkisë së Himarës nëpërmjet nëpërkëmbjes së vullnetit të sovranit. Kjo nisi me një autorësi. Zoti Kaso me të drejtë tha se këtij procesi kërkohet që t'i fshihet fytyra dhe t'i falet dikuj tjetër autorësia. Mirëpo është bërë e qartë gjatë këtyre 14 muajve se subjekti që kishte vënë për qëllim dhe do të përmbushë misionin e rrëmbimit të Bashkisë së Himarës është Partia Socialiste dhe kreu i saj Edi Rama. Në këtë periudhë 14 mujore do të mund të rendisja me dhjetra nene të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, yë Kodit Zgjedhor të Republikës së


*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

Shqipërisë, të Ligjit për Funkcionimin e Pushtetit Vendor në Republikën e Shqipërisë dhe kështu me radhë, do të ishin pa mbarim. Po kufizohem vetëm në disa. Zotit Beleri, Kryetarit të Bashkisë së Himarës dhe anëtarit të Parlamentit Europian i është privuar e drejta elementare të zgjedhë. Nuk besoj se kërkohen referenca, se ku mbështetet kjo e drejtë. Nuk i është dhënë me 14 Maj si gjithë qytetarëve të tjerë, si gjithë të paraburgosurve dhe të burgosurve të tjerë, që nuk u është privuar me vendim gjykatë e drejta e votës që të shprehë vullnetin e tij. Pra nuk ka votuar zoti Beleri. E dyta, zotit Beleri i është privuar e drejta të zgjidhet, në një kohë që edhe edhe juve si hallka më e rëndësishme e njohjes së rezultatit, konfirmimit dhe dhënies së mandatit e keni dhënë pëlqimin tuaj. Nuk është përmbushur detyrimi kushtetues i të drejtës që të zgjidhet duke marrë përsipër detyrën që i ka kërkuar sovrani. Pra zotiti Beleri njëherësh i janë privuar të dy të drejtat kushtetuese, edhe të zgjedhë edhe të zgjidhet. Po vimë të komuniteti i Himarës. I është privuar e drejta kushtetuese të zgjedhë përfaqësuesin e vet. Prej 14 muajsh komuniteti, Bashkia e Himarës drejtohet në mënyrë abusive dhe ndërkohë që mund të gjendet artifice për periodha të caktuara kohore drejtimi, sot drejtohet nga një kryetar i komanduar i cili është komandim i një ish nën/kryetareje të komanduar. A mund të ketë një shtet të së drejtës diku në botë që njeh situatë të tilla juridike si serioze dhe kushtetuese. Pra kemi të bëjmë me një zinxhir shkeljesh në drejtime të ndryshme dhe vazhdoj, zoti Beleri është arrestuar me pretendimin në flagrancë, në një kohë që provohet se nuk kishte asnjë flagrancë. Ishte thjesht me avokatin e tij dhe me një të afërt të tij. I bie se ishte duke bërë korrupsion, duke blerë votën e avokatit apo të të afërmit të vet. Zotit Beleri i është privuar liria me një dëshmi penaliteti të falsifikuar. Sistemi zyrtar i gjenerimit të dëshmive të penalitetit përpara zhvillimit të zgjedhjeve të 14 Majit, siç e keni konfirmuar edhe vetë ju me dëshminë e penalitetit që keni gjeneruar sipas ligjit dhe të drejtave që ju jep legjislacioni, rezultonte i pa dënuar. Ditën që u zhvillua

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

seanca gjyqësore për masat e sigurisë ndaj zotit Beleri, çuditërisht sistemi gjeneron një dëshmi penaliteti ku figuron i dënuar dhe menjëherë pas asaj date, sërish sistemi gjeneron një dëshmi penaliteti ku figuron i pa dënuar. Pra çudia ndodhi vetëm për një ditë ose për disa orë. Zoti Beleri dënohet me vetëm një dëshmitar, i cili jep dëshmi kontradiktore, një dëshmitar i cili pohon se është paguar nga policia e shtetit, gjë që konfirmohet edhe nga drejtuesi i atëhershëm i Komisarariatit të Policisë së Himarës. Në një kohë që kjo pohohet publikisht në sallën e gjyqit, Policia e Shtetit refuzon t'i japë të dhëna edhe Gjykatës vetë se në çfarë shume, për çfarë arsye dhe në çfarë kushtesh është paguar pseudo dëshmitari ndaj zotit Beleri dhe nga ana tjetër vijmë në momentin kur, në një kohë që padia e zotit Beleri për dëshmi të rreme ndaj dëshmitarit kundër tij kishte një vendim, fillimisht u refuzua nga Prokuroria e Posaçme, në vazhdim pati një vendim të Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në favor të zotit Beleri, kjo u mbajt e fshehtë derisa u zhvillua gjykimi në Apel me qëllimin e vetëm që të realizohej misioni, i cili nuk ishte juridik, cili ishte thjesht dhe vetëm politik. Përse i nderuar zoti Komisioner i përmenda këto fakte që normalisht nuk do të ishin teza që në pamje të parë do të dukej e arsyeshme të artikulohehin në këtë sallë. E them për të arritur në një konkluzion se për realizimit të misionit politik të rrëmbimit të Bashkisë së Himarës dhe të implementimit të projekteve uzurpuese të pronave në Himarë nga zoti Rama, u shkelën një sërë parimesh konventuale kushtetuese dhe ligjore. Nga ana tjetër u përdorën shumë institucione për të humbur autorësinë. U përdorën segmente të Policisë së Shtetit dhe nuk është në nderin e tyre. U përdorën individë në radhët e drejtësisë dhe nuk është në nderin e tyre dhe kjo do të zbardhet në mënyrë **palegjirike** në Strasbourg. Sot këtij procesi të rrëmbimit të Bashkisë së Himarës, autori i saj Edi Rama kërkon t'i vejë vulën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ju lutem ruajeni integritetin, ruajeni imazhin dhe nderin e këtij institucioni që është garanti i votës së lirë që përbën

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

themelin e sistemit tonë demokratik. Nëse edhe juve do të bëheni palë për humbjen e gjurmëve të këtij procesi të shëmtuar për jetën tonë politike dhe institucionale, do të jetë thjesht hallka e përdorur institucionale e radhës, sepse e vërteta nuk ka asnjë gjasë dhe mundësi që të mos zbardhet ashtu edhe më gjerë opinionin në vendin tonë. Mos i jepni mundësinë zotit Beleri që në sallën e Parlamentit European të ketë mundësinë që të pëmendë bioma negative edhe përsa i përket institucionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ju falenderoj !

Z.I.Celibashi: Faleminderit zoti Dule!

Po zoti Beleri fjala është për ju.

Z.Dh.Beleri (Kryetar I zgjedhur I Bashkisë së Himarës): I nderuar zoti Komisioner do të doja në radhë të parë t'ju falenderoj që më dhatë mundësinë të shprehem dhe unë. Juristët dhe zoti Dule besoj se shumicën e gjërave që doja të thoja, i thanë. Duket qartë që nuk ka bazë ligjore për shqyrtimin e sotëm. Dikush do të nxjerrë gështenja nga zjarri me duart e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Institucioni që ju drejtoni është i vetmi institucion që deri tani ka ruajtur nderin e këtij shteti dhe ka qenë brenda kuadrit ligjor, të gjitha institucionet e tjera janë bërë pjesë e paligjshmërisë, padrejtësive që më janë bërë mua dhe pjesë të banorëve të Himarës që më kanë votuar për të drejtuar. Siç erdha sot këtu unë do të kisha vajtur dy orë në Himarë dhe të isha betuar vullnet politik ishte sot përveç dashmarësisë dhe

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 05.07.2024*

kërkesës suaj Drejtoria e Burgjeve që është në varësinë e Ministrit të Drejtësisë dhe Kryeministrit më dhanë leje. Këtë leje fare thjesht mund ta merrja për të bërë betimin, ata që vendosën rrëmbimin e Bashkisë së Himarës, dhunimin e sovranit ata që nuk duan që himariotët të shprehen duhet t'i lini të pijnë gotën helmin deri në fund. Unë duhet të betohem dhe të më shkarkojnë ashtu siç thotë ligji dhe Kushtetuta. Jam i qartë dhe unë që mandati si Kryetar i Bashkisë së Himarës ka mbaruar, unë ju flas se këta do e bëjnë rrugë do ketë vazhdim duket qartë arroganca e tyre, dëshira e tyre që t'i bëjnë zgjedhjet kur ata duan, t'i bëjnë në mes të gushtit në një periudhë që e gjithë bota bën pushimet dhe në Himarë është muaji që nxjerrin të ardhurat për gjithë vitin. Pse duhet t'i bëjnë në atë muaj dhe pse duhet që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve t'i bashkohet kësaj kërkesë? Kam frikë se gjysma e bashkisë do të shkojnë në burg kanë dy nënkryetarë bashkie në mënyrë të paligjshme të emëruar. Kryetar në detyrë është subjekti i SPAK-ut, gjysma e administratës e bashkisë janë subjekti i SPAK-ut nga relacioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit për punën e tenderave, ata kanë një ankth, ankthin e tyre ta kalojmë në mes rrugës ligjore. Në qoftë se ju nuk mund të merrni sot një vendim siç e thanë dhe avokatët e mi zoti Kaso dhe zonja Gjyzari do t'ju lutesha meqë kam vakancë ligjore në qoftë se mendoni që ka t'i drejtohem kushtetutës për ta zgjidhur këtë punë një herë e mirë dhe ju thashë dhe një herë për rata që do të vijnë se duket qartë se do e bëjnë rrugë. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit zoti Beleri!

Kemi ndonjë diskutim tjetër me këtë çështje para se ta përfundojmë hetimin administrativ? Ndonjë dokumentacion që doni ta administroni si provë? Nuk kemi

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

mesa duket. Faleminderit të gjithëve për kontributin nëse nuk kemi ndonjë fjalë të fundit për t'u thënë për të vazhduar pastaj më tej.

Z.E.Salianji (Përfaqësues i PS-së):: Fjala e fundit akti siç e ka sjellë administrata relacioni shpjegues dhe i qartë dhe nga ana ligjore dhe procedurale se kemi një relacion që po shqyrton mbledhjen dhe vendimarrja juaj të jetë konform aktit dhe procedurës që stafi i KQZ-së ka sjellë për shqyrtim sot.

Z.I.Celibashi: Po e nderuar avokate!

Znj.K.Gjyzari(avokate): Si subjekt i interesuar preferoj të flas e fundit siç dhe e deklarova, relacioni dhe vendimi kanë filluar një procedurë të pvefshme për arsye se nuk është në kompetencën e KQZ-së gjithashtu ka konfuzion ndërmjet diospozitave ligjore të zbatuara sin ë relacion ashtu edhe në projektvendim është intepretuar gabim ligji 138 i vitit 2015 po ashtu dhe Kodi Zgjedhor për sa i përket kompetencave të KQZ-së mënyrën e funksionimit të KQZ-së në këto raste dhe vendimarrjes që mund të marrë KQZ-ja në këto raste kështu që i qëndroj kërkesës me pushimin e procedurës sepse është në tejkalim të kompetencave që ligji parashikon KQZ-së. Siç e thashë dhe më përpara nuk e kuptoj këtë urgjencë kaq të madhe nuk jemi në periudhë zgjedhore mund t'i kishim lënë KQZ-së një kohë të shqyrtonte pretendimet me qetësi dhe ne të përgatiteshim. Nuk e kuptova këtë nxitim kaq të madh Kodi Zgjedhor ka parashikuar afatet e shkurtra vetëm në periudhë zgjedhore, jashtë peridhës zgjedhore nuk ka në dijeni time nuk keni periudhë

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 05.07.2024*

zgjedhore. Kështu që do ti kërkoja KQZ-së të marrë kohën e mjaftueshme për t'u shprehur në lidhje me sa u relatua në seancë. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Besoj nuk kemi gjë tjetër në lidhje me këtë çështje nga ana e palëve pjesmarrëse. Në lidhje me këtë çështje dhe në terësi në këtë shqyrtim administrativ do të doja të thoja që në krye të herës që ky process administrative dhe vendimarrja që do ta pasojë nuk ka asnjë nxitje tjetër jashtë asaj që KQZ-në e nxit ligji për dekriminalizimin, Kodi Zgjedhor, Kushtetuta në përgjithësi legjislacioni shqiptar. Natyrisht secila prej palëve pjesmarrëse në këtë shqyrtim administrativ po dhe të tjerë jashtë saj mund të kenë gjykimet dhe vlerësimet e tyre mbi këtë sa unë thashë po është fakt i pakundërshtueshëm sepse nuk ka asnjë provë për të provuar të kundërtën që në këtë proces KQZ nuk është futur as për t'i shërbyer dikujt dhe as për të prishur dhe dëmtuar interesat e dikujt edhe pse vendimarrja natyrisht shkon në interes të dikujt dhe kundra interesave të dikujt tjetër, por ashtu sikurse çdo vendimarrje më së shumti organeve gjyqësore dhe pse KQZ-nuk është gjykatë është e tillë që jo të gjitha palët i kënaq ose kënaq interesat e tyre. Ndjej nevojën për ta bërë këtë sqarim jo për shkak të një kompleksiteti edhe kur dihen gjërat është mirë të thuhet sepse konsolidon opinionin e atyre që e kanë këtë opinion por ndoshta i bën të **cedojë?** në opinionin e kundërt të tjerët. Natyrisht nuk kemi pse ta fshehim të gjithë ngarkesën që përmban kjo çështje dhe në këtu jetojmë të gjithë dhe padyshim që duke qenë një çështje që ka atë rëndësinë që ka pa e përkufizuar konkretisht këtë rëndësi në fund ngelet ajo që san ë përputhje me ligjin është kjo vendimarrje. Unë mendoj që dhe për të vazhduar konkretisht me arsyetimin ligjor të këtij procesi administrativ dhe me vlerësimin ligjor të çfarë përmban në terësinë e vet ky proces. Do të doja të thoja që KQZ është plotësisht kompetente për ta zhvilluar këtë process

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

administrativ e thashë dhe në krye të herës që “dëshira” për t’u marrë nuk buron nga asgjë tjetër vecse imponohet nga ligji. Paraprakisht do të thoja në referim të asaj çfarë thatë ju zonja avokate që në këtë proces administrativ të parë nga pikëpamja formale Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka respektuar të njënjtat procedura, afate dhe ka zhvilluar të njënjtin proces sikurse me qindra raste të tjera do të thotë që kjo çështje nuk është shqyrtuar duke pasur një nxitim nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë afate të cilat i ka parashikuar Kodi Zgjedhor dhe pak a shumë brenda këtyre afateve plus minus një ose dy ditë ne kemi shqyrtuar dhe raste të tjera pask a shumë të ngjashme dhe pse dallon në fakt rasti i Belerit shumë në thelbin e vet ligjor nga pothuasje të gjitha rastet e tjera që ka shqyrtuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në çështjet që lidhen me dekriminalizimin. Duke e konsideruar të pranuar të paktën në gjykim dhe në arsyetimin tim të gjithë të drejtën e KQZ-së për t’u marrë me këtë çështje, le të vi tek thelbi i saj tek bazueshmëria e pretendimit për pavlefshmëri të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë zotit Beleri. Ligji për dekriminalizimin ka si qëllim të vetin që të ndaloj dhe të largoj që në nenin 1 të këtij ligji të gjithë ata funksionarë publik pra të mos kandidojnë por dhe ata të cilët e kanë marrë këtë funksionin publik në kushtet kur kanë kryer vepra penale të caktuara apo masa dënimit të caktuar. Natyrisht që për rastin kur kandidon kjo është e qartë për të gjithë ku kompetenca e KQZ-së dhe ushtrimi i kësaj kompetence është e qartë për të gjithë. Diskutimi ngelet nëse një person i cili e ka marrë këtë funksion publik gjatë ushtrimit të detyrës, kryen një vepër penale dhe merr një masë dënimi a është ky ligj i cili vepron ndaj këtij personi po apo jo? Ky është diskutimi pak a shumë që bëtë ju ose pikëpytja që ju sollët po ju kishit bindjen që në këtë rast nuk mundet që KQZ në bazë të ligjit për dekriminalizimin mund të disponojë mbi mandatin e disa funksionarëve publik që ka përcaktuar ligji përkatës. Nuk është çështja e KQZ-së se çfarë mund të bëjnë insitucionet e tjera Qeveria, Kryeministri është në vlerësimin e tyre për të

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

marrë nisma vendimarrëse të caktuara për këto raste apo raste të tilla të ngjashme. Vendimarrja dhe iniciativa e KQZ-së nuk është aspak e kondicionuar me atë se çfarë bëjnë institucionet e tjera, vendimarrja e KQZ-së dhe procesi që mund të nisë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcaktohet nga Kodi Zgjedhor ose në rastin konkret në ligjin për dekriminalizimin. Situata është e tillë ne kemi një kryetar bashkie të zgjedhur I cili nuk është më në detyrë për ato arsye që tashmë janë bërë publike pra nuk ka ndodhur ta ushtrojë funksionin e kryetarit të bashkisë edhe pse me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është shpallur fitues, është vlerësuar ky mandat dhe nga gjykatat përkatëse por nuk është në kushtet e ushtrimit të detyrës po për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kjo nuk ka fare rëndësi në kuptim të ligjit të themi mund të ishte dhe në kushtet kur ishte duke ushtruar detyrën dhe po e marrim rastin sikur ai do të kishte detyrën e Kryetarit të Bashkisë dhe ngelet diskutimi në kushtet ku verifikohet që personi i zgjedhur kryetar bashkie ka kryer një vepër penale për të cilat ligji ty të ndalon të kandidosh a e ka kompetencën Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bazë të ligjit për dekriminalizimin për ta zhvlerësuar këtë mandat. Unë jam i bindur se po e ka këtë të drejtë dhe këtij ligji i nënshtrohen më shumë akoma ata të cilët e kanë marrë këtë detyrë ty ligji të ndalon të mos kandidosh në disa kushte aq më shumë akoma nuk mund të lejohet ta ushtrosh këtë detyrë kur verifikohen kushtet e ndalimit. Pak a shumë kjo është is një klub të ketë disa rregulla sipas këtyre rregullave ty nuk të lejohet të hysh në këtë klub nëse je sherrxhi të themi, nuk ka lidhje krahasimi me zotin Beleri në këtë rast por thjesht për qartësi për të kuptuar ndoshta dhe më shumë opinion publik dhe ti do të hysh në atë klub e ke të gjithë background-in tënd të pastër sepse nuk ke pasur asnjë episode të tillë hyn dhe në momentin që krijon sherr aty do të themi që meqënëse se ti u kualifikove për të hyrë nuk mund të dalësh nuk besoj se ka kuptim që të pranojmë që po kjo përjashtimisht në rastin për ligjin dekriminalizimin mund të lejohet. Ndaj

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.05.07.2024*

sepse ligji për dekriminalizimin nuk do të kishte pikën e kuptimit në gjykimin dhe vlerësimin tim nëse ne ndalojmë dikë të kandidojë kur janë disa kushjte të cilat ligji i konsideron si ndaluese dhe i themi personit ti vazhdo qëndro në detyrë edhe pse ke kryer një prej atyre veprave penale për të cilat ligji ty të ndalon të kandidosh. Do të dua ta pranoj që ndoshta kaq qartë dhe kaq literale në ligj kjo nuk është e shkruar por në kuptim dhe interpretim terësor të përmbajtjes dhe qëllimit të atij ligjit unë mendoj se kjo është shumë e qartë. Jo vetëm për rastin e zotit Beleri, por këdo rast tjetër të ngjashëm kam të gjithë keqardhjen që për shkak të ligjit të dekriminalizimit të humbasin mandatin apo funksionet publike ata të cilët janë zgjedhur apo i kanë marrë këto funksione por në fund të fundit ky është ligji. Nuk jam në pozitën për të komentuar sesi kemi ardhur në këtë situatë por situata kjo është ku personi në fjalë i zgjedhur tashmë ka një vendim penal të formës së prerë për një vepër penale për të cilën ligji të ndalon edhe të kandidosh dhe aq më shumë akoma të ndalon për ta mbajtur atë funksion publik sepse për ndryshe do të duhet të pranohet dhe ndjesë që po i referohem zotit Beleri se nuk është se ka të bëjë konkretisht ajo çfarë dua të arsyetoj me të pra i themi dikujt që në rregull e ke kryer këtë vepër penale vazhdon qëndron në detyrë sepse nuk e kishe kryer atëherë e kishe kryer, pasi ke marrë ose është verifikuar pasi ke marrë detyrën por nëse do të konkurosh në zgjedhjet e ardhshme të lejohet të qëndrosh në detyrë por të ndalohet të konkurosh nuk besoj se ka shumë sens dhe logjikë formale. Ndaj ne me bindje të plotë tej çdo komenti që gjithësekush është i lirë për t'i bërë unë mendoj që ne jemi në kushtet e humbjes së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë zotit Dhionisios Alfred Petro Beleri dhe shpallim të pavlefshëm këtë mandat.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi dhe ky vendim

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Faleminderit!

Vendim Nr.69

[Type here]

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*

